

 REPUBLIC OF ALBANIA KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
Prantuar	24.12	2018	
Nj. Org.	02	Numër	400
		Shtojca	74759
		Vlera	



Kuvendi Komunal-Glogoc
Departamenti për Administratë dhe Personel

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

në mes

GIZ –Projekti për Të drejtat sociale për grupet vulnerabël- SoRi
– Prishtinë dhe Komuna e Glogoc/Drenas

I. Qëllimi:

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e mëtejshëm Memorandumi) lidhet në mes të GIZ – Projekti për të drejtat sociale të grupeve vulnerabël(në tekstin e mëtejshëm SoRi) dhe Komunës së Glogoc/Drenas me qëllim që të identifikojë rolin dhe përgjegjësitë e secilës palë-subjekt në implementimin e projektit të GIZ-it, SoRi

II. Objektivat e Programit SoRi

Projekti i GIZ - SoRi është projekt i filluar në tetor të vitit 2015 në kuadër të bashkëpunimit të Organizates Gjermane per Bashkepunim Nderkombetar – GIZ me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe përbëhet nga:

Objektivi: Aktorët kryesorë kanë përmirësuar kushtet për sigurimin e të drejtave të barabarta sociale për grupet në nevojë në komunat e përzgjedhura.

Fusha e Veprimi 1 - Shërbimet sociale: palët e interesuara lokale (qendrat për punë sociale, zyrat për komunitete dhe të kthyer, administratat komunale, OJQ-të) kanë përmirësuar kapacitetet e tyre për punë në terren me grupet vulnerabël.

Fusha e veprimi 2: Edukimi dhe ngritjen e vetëdijes: aktorët lokalë, p.sh. qendrat për punë sociale, administratat komunale, OJQ-të, kanë rritur angazhimin e tyre për ngritjen e vetëdijes së grupeve të rrezikuara për të drejtat e tyre sociale, përfshirë edhe të drejtën për mosdiskriminim, së bashku me institucionet kombëtare kundër diskriminimit dhe të drejtat e njeriut.

Fusha e Veprimi 3: Financimi për shërbimet lokale sociale: Zgjidhje për financimin afatgjatë të shërbimeve sociale lokale për grupet në nevojë janë në zhvillim.

Fusha e veprimi 4: Shpërndarja e përvojave; aktorët lokalë dhe kombëtarë kanë përmirësuar kushtet për shpërndarjen kombëtare dhe rajonale e qasjeve të suksesshme lokale në përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël.

R. H

III. Roli dhe përgjegjësitë e palëve

1. GIZ – Projekti SoRi do të jetë përgjegjës për implementimin e aktiviteteve të cekura në vijim:

- Ndërmarrja e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në nivel komunal të akterëve të kyçur në grup punues, për identifikimin, arritjen dhe qasjen tek grupet më vulnerabël të popullsisë, në komunat përkatëse;
- Ndërmarrja e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në nivel komunal të të gjithë akterëve, për të drejtat e njeriut, respektivisht të drejtat sociale;
- Asistimi në formimin dhe funksionimin e grupit punues, ndër-sektorial, në nivel komune (sipas termave të referencës që do të përcaktohen për këtë grup);
- Asistim në ofrim kualitativ të të gjitha shërbimeve për grupet më vulnerabël (fushat dhe temat e trajnimit do të identifikohen bashkërisht ndërmjet GIZ dhe Komunës);
- Ngritje të kapaciteteve për identifikimin, aplikimin dhe implementimin në fonde të ndryshme, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme në nivel komunal;
- Asistencë në rrjetëzimin dhe bashkëpunimin ndërkomunal, në vend dhe rajon
- Përkrahje për shërbimet në terren si dhe për aktivitetet vetëdijësuese (duke përfshirë këtu edhe shpërndarjen e informatave dhe kampanjat vetëdijësuese);
- Asistencë në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në kuadër të arritjes dhe qasjes në grupet vulnerabël, por edhe ofrimin e shërbimeve, sipas nevojës, për këto grupe

2. Drejtorja përkatëse në Komunë:

Mbështetjen dhe asistencën në implementimin e aktiviteteve të sipërpërmendura përmes:

- Mundësimin në përzgjedhjen e stafit të nevojshëm (Kordinatorja për të drejta të njeriut si person kyç) për pjesëmarrje në aktivitetet e ndryshme duke përfshirë edhe punën në terren gjatë orarit të rregullt të punës në harmoni me legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhënien e punës;
- Përzgjedhjen e stafit profesional për pjesëmarrje të rregullt në takimet koordinuese, punëtoritë, trajnime, vizitat studimore si dhe aktivitetet tjera të parapara në projekt;
- Mundësimin e qasjes së stafit profesional të GIZ-it në Institucione të ndryshme komunale, me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të punëve së bashku me Kordinatorin/Kordinatorin për të drejta të njeriut.

R. Li

IV. Kohëzgjatja e Memorandumit

Kohëzgjatja e këtij memorandumi është nga dhjetori i 2015 deri me shtator, 2019 por mund të shkëputet edhe para përfundimit të kësaj periudhe kohore në rast se paralajmërohet në afat kohor prej 1 muaji nga cilado palë në bashkëpunim. Me marrëveshje në mes të palëve, kohëzgjatja e këtij memorandumi mund të ndryshojë.

V. Aneks

Pjesë e këtij memorandumi është edhe shtojca që ka të bëjë me qellimet, objektivat, fushëveprimet dhe indikatorët kryesor të projektit për të drejtat sociale të grupeve vulnerabël-SoRi.

GIZ – Projekti SoRi

Komuna Gllogoc/Drenas

for Z. Michel Samec, Udhëheqës i Projektit
Michel Samec

Prishtinë, dt. 24.12.2018

Z. Ramiz Lladrovci, Kryetar

Ramiz Lladrovci

